

SEIT MANSAKU

VENDI I MARTIN CAMAJT NË STUDIMET BUZUKIANE

Krijimtaria letrare, filologjike dhe gjuhësore shkencore e Martin Camajt bën pjesë në trashëgiminë e zgjedhur të letërsisë, të gjuhës dhe të kulturës sonë kombëtare të gjysmës së dytë të shekullit XX. I larguar nga vendi i tij për më se një gjysmë shekulli, jetoi në Perëndim, jetoi gjithë kohën me kujtimet dhe përjetimet e vendlindjes dhe iu përkushtua krijimeve letrare e studimeve gjuhësore për gjuhën shqipe me zell dhe pasion të pashoq dhe falë punës dhe talentit të tij, kontakteve me kulturën dhe shkencën e botës së përparuar, arriti të linte një vepër letrare dhe filologjike që ngërthen në vetvete traditën më të mirë të vendit të tij dhe metoda e ide të modernitetit perëndimor. Kjo e bën veprën e tij të zërë një vend të veçantë në letërsinë dhe në shkencën gjuhësore shqiptare.

Martin Camaj, si vazhdues në një kohë tjetër dhe në rrethana të tjera i veprës së Rilindasve, nuk e ndau krijimtarinë letrare nga studimet gjuhësore. Letërsinë e kishte pasion, gjuhësinë e zgjodhi për profesion dhe në të dyja këto fusha la një tashëgimi të çmuar, e cila për gati 40 vjet nuk u njoh në vendin që e lindi e për të cilin punoi pa u lodhur e me përkushtim të rrallë, megjithëse gjatë gjithë kohës jashtë vendit nuk pati as kohë as dëshirë të merrej me veprimtari politike dhe u angazhua tërësisht me punë krijuese e shkencore. “Në kushte normale, - ka pohuar ai - do t’ isha marrë tanë jetën me letërsi, por nga shkaku sesi i mërguem, më duhej një profesion, zgjodha gjuhësinë shqiptare që të mos ndahesha nga poezia”¹.

Edhe pse në atdheun e tij nuk i zihej emri as me gojë, as me shkrim, Martin Camaj, me sa munda, u përpoq t’i mbante lidhjet me krijimtarinë letrare e shkencore gjuhësore shqiptare dhe pati fisnikërinë të bënte herë pas here vlerësime pozitive për kolegë dhe vepra që botoheshin në vendin e tij. Në disa shkrime të tij e ka vlerësuar lart veprën e Çabejt dhe të kolegëve të tjerë nga Shqipëria dhe nga Kosova. Për këtë mjafton të përmendim një recension të tij për botimin kritik të “Mesharit” të Gjon Buzukut nga E. Çabej, recension i botuar në revistën “Shejzat”, të cilin e mbyll me këto fjalë: “I jemi mirënjohës studiuesit për këtë vepër të tij, vepra më e mirë filologjike e albanistikës deri më sot edhe kryevepër e

1. Cituar sipas një Interviste të Anton Berishës me Martin Camajn.

Çabejt. Vetëm mijëra shënime me komente të tekstit në çdo faqe dëshmojnë durimin dhe përpikëmerinë e një tradite të shkëlqyer filologjike². Merret me mend se sa keq do ta ketë ndjerë veten E. Çabej, një studiues me etikë profesionale e morale të lartë si ai, kur ka qenë i detyruar të mos e citonte e të mos përmendte emrin e Martin Camajt, të cilin puna studimore ia sillte në shteg herë pas here.

E vështuar nga kjo pikëpamje, vepra e Martin Camajt mban vulën e dy rrethanave të rëndësishme të jetës dhe të veprimtarisë së tij:

Së pari, vepra e tij u krijua larg ndikimeve e kufizimeve ideologjike në të cilat ishin të detyruar të punonin e të krijonin kolegët e tij në Shqipëri. Kjo i jep veprës së tij një përmasë lirie e pavarësie krijuese e shkencore, kaq e domosdoshme për të shprehur talentin dhe individualitetin krijues të autorit.

Së dyti, e krijuar në botën perëndimore, në qendra të njohura europiane të studimeve albanologjike dhe në mjedise të ngritura shkencore e kulturore, pranë bibliotekave e arkivave të pasura me literaturë të përgjithshme e albanologjike, vepra e M. Camajt ka përfituar nga burimet që ka pasur mundësi t'i shfrytëzojë dhe nga metodat dhe idetë e reja shkencore e krijuese që zbatoheshin në këto qendra të përparuara. Por pavarësisht nga këto rrethana, vepra e Martin Camajt frymëzohet nga vendlindja e atdheu i tij, nga traditat jetësore e kulturore shqiptare dhe trajton tema të rëndësishme për letërsinë, gjuhën dhe kulturën kombëtare. Në veprën e tij ndërthuren e shkrihen në një ndiesitë për vendin, për traditat, për gjuhën dhe kulturën e tij, mbresat, kujtimet, përvoja jetësore në përgjithësi që mori me vete kur u largua, me dijet e reja dhe përvojën e re që fitoi në botën perëndimore, në rrethet kulturore e shkencore të saj. Siç e ka shprehur në mënyrë sintetike studiuesi i njohur Anton Berisha, “vepra e Martin Camajt është e lidhur ngushtë me vendin e tij, me popullin e tij, me gjuhën e tij; ajo paraqet një simbiozë mes pajës shpirtërore autoktone me atë universale. “Me një fjalë, siç e ka pohuar dhe vetë Camaj për nga ndjesitë dhe angazhimi letrar shkencor e qytetar, *ai mbeti fund e krye shqiptar*. Ndërsa në rezultatet që arriti në letërsi dhe në shkencë ka pjesën e vet edhe përvoja e tij europiane.

Në veprën e tij gjuhësore Martin Camaj është marrë me filologjinë e teksteve të vjetra shqipe, me fjalëformim dhe etimologji, me gramatikë, me kërkime dialektore, me çeshtje të gjuhës standarde e kritikë gjuhësore etj.

² . Marin Camaj, *Meshari i Gjon Buzukut (1555)*, Botim kritik, punuar nga Eqrem Çabej. Pjesa e parë – hyrje dhe transliterim, pjesa e dytë – facsimile dhe transkribim fonetik, Tiranë, 1968, në “Shejzat”, nr.5-8, f. 284-285.

Nga pikëpamja e metodologjisë shkencore, vepra gjuhësore e M. Camajt mbisundohet nga ideja se shqipja duhet të studiohet në tërësinë e saj, duke përfshirë dialektet dhe të folmet e saj brenda dhe jashtë vendit, tekstet e vjetra dhe gjuhën e sotme. Këtë metodologji ka zbatuar në veprën e tij gjuhësore. Vetë ai ka pohuar se ka si parim themelor e metodë studimi vënien në marrëdhënie të të gjitha varianteve tradicionale të gjuhës së shkruar, gegërisht, toskërisht dhe arbërisht, për të arritur me anë të deduksionit të gjuha e sotme.

Një tjetër veçori e veprës shkencore të Martin Camajt është se ai përfaqëson tipin e studiuesit që qëndron larg diskutimeve teorike abstrakte dhe merret me probleme konkrete që mund të studiohen duke u mbështetur në dokumente e materiale, në tekste të ndryshme e të dhëna dialektore të ndryshme, të cilat mund t'u nënshtrohen analizave shkencore.

Në fushën e filologjisë së teksteve të vjetra të shekujve XVI-XVII vepra e tij më e rendësishme është “Il Messale di Gjon Buzuku”, botuar në Romë më 1960 në serinë “Shejzat”. Është një vepër jo e vëllimshme me rreth 90 faqe, por e ngjeshur me ide dhe probleme themelore për çështje të rendësishme të grafisë së Buzukut dhe të fonetikës historike të shqipes, për traditën e shkrimit të saj, për gramatikën historike dhe për leksikologjinë historike, me ide dhe zgjidhje origjinale. Duke pasur parasysh kohën kur e shkroi këtë vepër, problemet e përgjithshme që shtroi dhe nivelin shkencor të trajtimit të tyre, besoj se nuk gaboj po të them se kjo vepër për librin e parë shqip e radhit autorin pas emrave më të shquar të studimeve buzukiane si E. Çabej, S. Riza, N. Resuli, W. Fiedler³.

Punën për njohjen dhe studimin e veprës së Gjon Buzukut M. Camaj e nisi në fund të viteve '50 me njohjen dhe studimin e “Mesharit” në një kohë kur kjo vepër nuk kishte njohur një botim të plotë e të transkriptuar. Botimi i Namik Resulit doli në vitin 1958, ndërkohë që botimi i Çabejt doli në vitin 1968. Dihet se pjesë të transkriptuara të “Mesharit” dhe studime për të ishin bërë edhe më parë nga Pal Skiroi, N. Jokli, J. Rrota, G. Petrotta, E. Çabej, S. Riza etj., por, me sa duket, M. Camaj ka punuar drejtpërdrejt me tekstin, sepse shembujt që ai jep për ilustrim janë nxjerrë nga origjinali. Vetë M. Camaj ka shkruar: “Ishte mes vjetëve 1956 e 1961. Në Romë pata mundësinë me pasë përduersh librin më të vjetër në gjuhën shqipe. Mbasi ende nuk kish ribotime të këtij libri, m'u donte me shkue përditë në bibliotekë me lexue në të. Rregulla e lypte me nënshkrue çdo

³ Për kontributin e Martin Camajt në studimet buzukiane shih dhe Rexhep Ismajli, *Kontributi i Martin Camajt në studimet buzukiane*, botuar te “ Meshari i Gjon Buzukut – monument ikulturës shqiptare”, Art Club, Ulqin 1995, f. 115-128.

ditë se e mora e se në fund e dorzova shëndosh, të pacënuem. Kjo sjellje me kohë shndërrohej në ritual e bahej pjesë e pandame e rrjedhës gjurmuese”⁴

Martin Camaj e nisi punën studimore me “Mesharin” e Gjon Buzukut me bindjen e shprehur edhe më parë nga Eqrem Çabej, se “të sqarosh shterrueshëm problemet filologjike të gjuhës së “Mesharit” buzukian do të thotë të zgjidhësh të gjitha problemet themelore historike të gjuhës shqipe”⁵. Ai filloi, siç është e natyrshme, u mor me njohjen e grafisë së “Mesharit” së cilës i kushtoi artikullin e parë studimor në këtë fushë, artikull i shkruar në serbo-kroatisht me titull “Kontribut për njohjen e grafisë së Gjon Buzukut”⁶, botuar në Sarajevë më 1957. Vetëm tre vjet më vonë botoi në Romë në italisht veprën “Il Messale di Gjon Buzuku” ku përfshihen kontributet e tij themelore për gjuhën e librit të parë shqip dhe disa teza të rëndësishme për historinë e këtij libri dhe për historinë e gjuhës së shkruar në përgjithësi. Në pjesën e parë u mor me grafinë e Buzukut dhe me disa çështje të mprehta të fonetikës historike të “Mesharit” si nazalizmi i zanoreve, çështja e h-së inorganike në fund të fjalëve që mbarojnë me zanore etj. dhe për të gjitha këto ka dhënë zgjidhje shkencore origjinale⁷.

Vepra e Martin Camajt për “Mesharin” e Gjon Buzukut ruan vlerat e saj shkencore edhe sot, kur kanë kaluar 50 vjet që kur është botuar dhe kur kanë dalë shumë studime serioze për këtë vepër. Ajo ruan vlerën e saj shkencore jo vetëm sepse për një kohë të gjatë mbeti e panjohur dhe pothuajse e pashfrytëzuar nga studiuesit shqiptarë, por se aty shtrohen, diskutohen dhe zgjidhen një varg problemesh të filologjisë së teksteve të vjetra dhe hidhen disa hipoteza origjinale lidhur me traditën e shkrimit të shqipes, lidhur me kompozimin e Mesharit, me diversitetin gjuhësor e stilor të kësaj vepre, me ngjashmëritë saj me vepra të tjera të këtij lloji të së njëjtës kohë në gjuhë të tjera etj., të cilat nuk kanë tërhequr sa duhet e sa meritojnë vëmendjen e gjuhëtarëve të kësaj fushe.

Pas një analize të thelluar të tekstit të “Mesharit”, duke bërë krahasime të të njëjtave pjesë të tekstit në faqe të ndryshme, M. Camaj ka vënë re se pjesë të këtij teksti kanë shumë dallime në gjuhë dhe në stil dhe ka bërë

⁴ .Martin Camaj, *Pjetër Bogdani mjeshtër i gjuhës dhe i stilit*, në “Shejzat..

⁵ Martin Camaj, “*Messale*” di Gjon Buzuku, *Contributi linguistici allo studio della genesi*, Roma 1960, f.71.

⁶ Martin Camaj, *Prilog poznavanju grafije Gjona Buzukua, “Godišnjak” I*, Balkanoloski Institut, Sarajevo, 1957, f. 203-211.

⁷ Për ndihmesat e e Martin Camajt në fushën e fonetikës buzukiane shih Rexhep Ismajli, *art. cit.*

përpjekje serioze për të shpjeguar arsyet e këtyre dallimeve gjuhësore e stilore. Ai ka arritur në disa përfundime interesante, të cilat, edhe kur mund të mos gjejnë miratim të plotë, nxisin mendimin shkencor të studiueseve për kërkime të mëtejshme. Së pari, kjo pabarazi në stil dhe në gjuhë sidomos në sistemin morfologjik, sipas autorit, nuk mund të shpjegohet me gjendjen e lëvrimin të gjuhës në shekullin XVI si një gjuhë e shkruar *in fieri*, ku bashkëjetojnë trajta të ndryshme për të njëjtën kategori gramatikore. Nga kjo rrjedh përfundimi tjetër se është vështirë të besohet se përkthimi i “Mesharit” është bërë nga një dorë e vetme dhe duke u mbështetur në një burim të vetëm në gjuhën latine, gjë që është vënë në dukje edhe nga Çabec dhe studiues të tjerë, por Camaj, është përpjekur ta argumentojë këtë tezë nëpërmjet krahasimeve me mesharë të tjerë në gjuhë të ndryshme.

Martin Camaj, njohës edhe i sllavishtes, ka meritën e veçantë se ka përdorur për krahasim shkrime të shenjta të përkthyer në sllavishten kishtarë edhe në kroatish dhe nga ky ballafaqim ka arritur në përfundimin se midis “Mesharit” të Gjon Buzukut dhe librave glagolitike në sllavishten kishtarë nuk ekziston asnjë lidhje. Përkundrazi, tekstet e para me shkrime të shenjta në gjuhën popullore kroate kanë pasur një ndikim të shënueshëm mbi librin tonë të parë në gjuhën shqipe. M. Camaj e shpjegon këtë me faktin se përkthimi në gjuhën popullore të teksteve të shenjta përbënte atëherë një lëvizje të vërtetë fetare e kulturore që zhvillohej gjatë bregdetit Adriatik nga Zara deri në Shqipëri. Një lëvizje e tillë u rrit aq sa tërhoqi vëmendjen e Kuries së Romës, e cila ndaloi përdorimin e këtyre përkthimeve nga frika e herezisë⁸. Siç shihet, M. Camaj nismën e Gjon Buzukut për përkthimin dhe botimin e shkrimeve të shenjta në gjuhën shqipe e vendos në kuadrin e një lëvizjeje më të gjerë dalmatino-veriore, që synonte përdorimin e gjuhëve popullore kombëtare në shërbimet fetare, lëvizje që ndoshta frymëzohej nga lëvizja protestante e shekullit XVI të Martin Luterit, mendim që e gjejmë edhe te Selman Riza⁹ e Injac Zamputi¹⁰. Para tyre, Mario Roques¹¹ ishte shprehur se “Buzukut ideja për t’u dhënë bashkatdhetarëve një libër lutjesh në gjuhën kombëtare do t’i ketë ardhur nga sllavët katolikë romakë të Bosnjës, Dalmacisë ose Sërbisë” dhe se “Buzuku do të ketë punuar nën një frymëzim françeskan”. Këtë ide

⁸. Martin Camaj, *Vep. cit.* f. 72.

⁹. Selman Riiza, *Pesë autorët më të vjetër*, Tiranë, 2002, f. 31

¹⁰ Injac Zamputi, *Mbi rrethanat historike të botimit të “Mesharit” të Gjon Buzukut*, në “Studime filologjike”, nr. 3, 1986, f. 185-202.

¹¹ Mario Roques, *Les ancins textes albanais*, Paris 1930, f. 15-16.

të tij Martin Camaj e mbështet në analizën e krahasuar të grafisë dhe të gjuhës së “Mesharit” me tekste të njëkohshme të së njëjtës natyrë në gjuhën kroate.

Martin Camaj e studioi tekstin e “Mesharit” të Gjon Buzukut si të kishte përpara një palimpsest, duke u përpjekur të dallojë në gjuhën e tij shtresa të ndryshme kronologjike dhe dialektore dhe nivele të pabarabarta të përpunimit të saj. Besojmë, thotë autori, se mund të pohojmë se më shumë se për një gjuhë të përbashkët të Buzuku kemi të bëjmë me një përzjerje artificiale të formave arkaike e dialektore, e cila ka prapa saj një traditë të shkruar të teksteve të shenjta në gjuhën shqipe. Nuk mund të shpjegohen ndryshe as ajo përkryerje stilore e gjuhësore në të cilën janë shkruar pjesët e ungjillit që lexohen në meshë në ditët festive, veçanërisht ato pjesë më të njohura e më të komentuara për besimtarët, siç janë parabolitë. Midis tyre ai veçon *Djalin plangprishës* që, sipas Camajt, është një kryevepër e vogël e stilit dhe e gjuhës shqipe.

Duke u nisur nga këto, autori nxjerr përfundimin se shumë kohë para Buzukut kanë ekzistuar përkthime të ungjillit në gjuhën shqipe dhe që përmes një tradite të gjatë përpunimi duke u përdorur dhe duke kaluar nëpër duar të kopistëve, me këto tekste është arritur një stil i vërtetë dhe i veçantë i shqipes dhe ajo që është më e mundur, është arritur në një pasurim të kësaj gjuhe kishtarë të përbashkët, e cila përfshinte forma të shumëllojshme të të folmeve krahinore me burim nga zona të ndryshme prej nga ishin edhe anëtarët e klerit shqiptar që përdornin këtë gjuhë¹². Buzuku, sipas Camajt, i ka përdorur këto tekste biblike dhe, më shumë se përkthyes i guximshëm, duhet konsideruar në mjaft raste një kompilator i mirë, megjithëse si prift i mësuar dhe i zellshëm do të ketë pasur përpara gjithmonë shkrime të shenjta në latinishte. Me këtë shpjegon Camaj faktin që Buzuku, edhe pse i zënë me punët e famullitarit, arriti ta përfundonte një vepër të tillë të vëllimshme në më pak se brenda një viti.

Me ekzistencën e shkrimeve fetare parabuzukiane nga burime të ndryshme dialektore, të shfrytëzuara nga Buzuku në hartimin e librit të tij, M. Camaj është përpjekur të shpjegojë edhe elementet e dialektit toskë që gjenden te “Meshari”. Së pari, ai ka vënë re se në librin e Buzukut ka gjurmë përkthimesh nga Ungjilli origjinal grek. Sipas tij, Buzuku gjatë përkthimit të Ungjillit shkëputet nga Vulgata dhe ndjek origjinalin grek, ndërkohë që këto nuk përputhen plotësisht në çdo pikë. Pikërisht në gjurmët e përkthimit të Ungjillit nga greqishtja M. Camaj sheh mundësinë e ekzistencës së shkrimeve fetare në dialektin e Jugut dhe të marrëdhënive

¹² Martin Camaj, *Vep. cit.*, f.34

fetare midis Veriut dhe Jugut të Shqipërisë, prej nga rrjedhin elementet toske në “Mesharin” e Gjon Buzukut¹³, një shpjegim origjinal, i ndryshëm nga studiues të tjerë të “Mesharit”.

Për të argumentuar këto ide të tij, M. Camaj ka krahasuar dy përkthime të së njëjtës pjesë të Ungjillit (Luca I, 26-38), që përmbahen e para në Officium B. M. V. dhe dyta në “Meshar”. Nga ky krahasim autorit i rezulton se ka dallime të dukshme midis pjesëve. Në pjesën e parë të Annunciazione del Officium B. M. V. reflektohet në shumë pika ndërtimi edhe fryma e Vulgatës latine të Shën Hieronimit, kurse versioni i dytë është më spontan e për pasojë më shqip në forma gramatikore dhe në leksik pa ndikime të huaja, më i lidhur me një traditë më të vjetër, me një strukturë sintaksore shqipe, një refleks i vjetër i tekstit grek¹⁴. Këtë M. Camaj përpiqet ta provojë duke shqyrtuar pjesë të Testamentit të Ri që gjenden te “Meshari” i Gjon Buzukut.

Në mbështetje të tezave të tij, Martin Camaj ka sjellë edhe karakterin arkaik të disa trajtave gramatikore që gjenden te “Meshari”, të cilat u përkasin, sipas autorit, atyre pjesëve të shkrimeve të shenjta, kryesisht të Ungjillit, të përkthyer në gjuhën shqipe para Buzukut. Njëra nga këto dukuri gramatikore arkaike është përdorimi i lidhore me kuptimin kohor e modal të kohës së ardhme

Te “Meshari”, siç dihet tashmë, krahas trajtës më të përgjithshme të së ardhmes së tipit *kam me punue*, përdoret me këtë vlerë edhe trajta e mënyrës lidhore dhe një herë të vetme trajta me foljen *dua+ lidhore*. Trajta e mënyrës lidhore me kuptimin kohor të së ardhmes së dëftores përdoret me këtë vlerë jo vetëm në fjali të varura, por edhe në fjali të pavarura dhe kryesore. P. sh., *Ndë atë mot tha Jezu dishepujet vet: Për pak mot ju të mos më shihni, e përparë për pak mot ju të më shihni*. (Meshari, f. 255, a). Lat. “Modicum et iam non videtis, et iterum videbitur me” (Gjoni XVI, 16); *E nuke t u la të vorfënë, por prapë të vijn tek ju*. (Meshari 263, b). Lat. “Non relinquam vos orphanos, veniam ad vos” (Gjoni XIV, 18); *E ju të më lypëni e të mos më vëgjani* = E ju do të më lypëni e nuk do të më gjeni. (Meshari 189, b). Lat. “Quaeritis me et non invenietis”. (Gjoni VII, 34); *Epna Danielë, në mos na ty të të nvrasëmë* = ...na ty do të vrasim. (Meshari 191, a). Lat. “Trade Danielelem’ alioquin interficiemus” (Danieli XIV, 29); *E u të ecinj për vjedmis juve e u juve t u jem për Zot, e ju të më ini për popullë*. (Meshari, 273, b). Lat. “Ambulabo inter vos et ero voster Deus, vosque eritis populus meus” (Levitiku, 26, 12).

¹³ .Martin Camaj, *Vep. cit.* f. 68, 69.

¹⁴ .Martin Camaj, *Vep. cit.*, f. 35, 42

Që këto trajta të lidhore së tashme dhe të kryer te “Meshari” i Gjon Buzukut kanë vlerën modale e kohore të së ardhmes së dëftores, kjo del qartë si nga përmbajtja e tekstit shqip dhe nga korelacioni i trajtave mënyrore e kohore me të cilat hyjnë në lidhje këto trajta të lidhore, ashtu edhe nga teksti përgjegjës latin, në të cilin trajtave të lidhore në shqip u përgjigjen trajta të së ardhmes në latinisht. P. sh., *E kur Krishti ka me ardhunë, askush s ka me ditunë se kaha të vinjë* (= *kah do të vij* - S. M.) në “Meshari”, f. 175, a. Lat. “sed hunc scimus unde sit, Christus autem cum venerit.” (Gjoni, 7, 27); *Për të vërtetë, për të vërtetë u juve thom: se në gjegjt kush fjalëtë e mi, mort të mos shohë.* (= *nuk do të shohë* - S. M.) *për jetë të jetësë.* (Meshari, f. 187,b). Lat. “Amen, amen si quis sermonem meum servaverit, mortem non videbit in aeternum” (Gjoni, 8, 51). Në të njëjtën faqe, pothuajse në të njëjtën frazë Buzuku përdor për foljen *shoh* trajtën e së ardhmes me *kam* + paskajore: *...e ti thuo se në mbajtët kush fjalëtë e tu aj s ka me pamë mort kurajtë.* (Meshari, 187, b). Lat. “Si quis sermonem meum servaverit, non gustabit mortem in aeternum.” (Gjoni, 8, 52). Pra kemi *mort të mos shohë* = *s ka me pamë mort* për trajtat respektive latine *videbit, gustabit*. Përveç kësaj, ka raste kur trajta e së tashmes së mënyrës lidhore me vlerën kohore të së ardhmes paraprihet jo nga pjesëza e mohimit *mos*, karakteristike për këtë mënyrë, por nga pjesëza *nuk*, çka tregon se kemi të bëjmë me modalitet të mënyrës dëftore. P. sh., *E nuk t u la të vorfënë por prapë të vinj tek ju.* (Meshari f.263, b). Lat. “Non relinquam vos orphanos, veniam ad vos” (Gjoni 14, 18).

Siç shihet, Buzuku përdor herë mënyrën lidhore me vlerën e kohës së ardhme *të shohë*, herë të ardhmen e tipit *kam* + paskajore *ka me pamë* në të njëjtin kontekst e për të njëjtën përmbajtje. Ato u përgjigjen trajtave të së ardhmes së tekstit latin *videbo, gustabo*. Kjo dëshmon se të paktën për autorin e librit të parë shqip këto dy trajta përdoren si sinonime gramatikore. Ja edhe një shembull tjetër në të njëjtin paragraf të Mesharit, ku këto trajta përdoren si sinonime gramatikore: *ai qi ndë muo beson, edhe në kloftë vdekunë, ai të gjëllinjë; e kush gjallë ashtë e beson ndë muo, s ka me vdekunë për jetë të jetësë.* (Meshari, f.183,b). Lat. “Qui credit in me, etsi mortuus fuerit, vivet; et omnis qui vivit et credit in me, non morietur in aeternum. (Gjoni, 11, 26).

Te “Meshari” i Gjon Buzukut jo vetëm e tashmja e mënyrës lidhore përdoret me vlerën e së ardhmes së mënyrës dëftore, por edhe e pakryera përdoret me vlerën e së ardhmes në të shkuarën ose me vlerën e mënyrës kushtore. Madje me këto vlera takohet edhe e ashtuquajtura trajtë e lidhore-habitores. P. sh., *A të donjit me klenë dishipujtë e tī* (Meshari, f. 179, a). Lat. “Vos vultis discipuli eius fieri” (Gjoni, 9, 27); *Ky në mos*

klenëke bākeq, na nuk ta kishnjëmë dhanë ndër duor. (Meshari, f.223,a). Lat. Si non esset hic malefactor, non tibi **tradidissem** eum. (Gjoni, 18, 30); *E na por prisnjim se aj ish qi të shpërblj* (= do ta shpërblente- S.M.) *Izraelnë* (Meshari, f. 243, a). Lat. “Nos sperabamus quia ipse **esset redempturus** Israel”(Luka,24, 21).

Për të ashtuquajturën trajtën e lidhore-habitores me vlerën e kohës së ardhme do të sillnim shembujt e mëposhtëm: *E ky në mos ish sinëzot nukë të mujtke* (= nuk do të mundte - S. M.) *me bām ndonjë kafshë.* (Meshari, f. 179, a). Lat. “Nisi esset hic a Deo non **poterat** facere quidam” (Gjoni, 9, 33); *E u përgjegj Jezu e u tha: As muo nuk më njihni, as Atënë tem; e ju në njihnitë muo e Atënë tem të njohkishtë* (= do të kishit njohur - S. M.) “Meshari, f. 185, b. Lat. Respondit Jesus: “Neque me scitis, neque Patrem meum, si me **sciritis**, forsitam Patrem meum **sciretis**”(Gjoni, 8, 19). Te dom Simon Filipaj, *Bibla*, f. 1519 kjo frazë është përkthyer kështu: “Ju nuk më njihni mua as Atin tim. Po të më njihnit mua, **do ta njihnit** edhe Atin tim”. Pra trajta latine **sciretis** te Buzuku është përkthyer me të ashtuquajturën lidhore-habitore të së pakryerës: **të njohkishtë**, te Filipaj me të ardhmen e së shkuarës ose me kushtoren: **do ta njihnit**.

Nga sa u parashtrua më lart del se përdorimi i trajtës së mënyrës lidhore me vlerën e kohës së ardhme te “Meshari” i Gjon Buzukut nuk është një dukuri e rastësishme, por pjesë përbërëse e sistemit foljor të gjuhës së këtij teksti, që mund të përfaqësojë një gjendje gjuhësore më të hershme të shqipes mesjetare.

Si mund të shpjegohet dukuria e përdorimit të trajtës së mënyrës lidhore me vlerën e kohës së ardhme në “Mesharin” e Gjon Buzukut? Me sa dimë ne, Martin Camaj¹⁵ është i pari që u përpoq ta shpjegonte këtë dukuri gramatikore të librit të parë të gjuhës shqipe të cilën e cilësoi si lidhore dëshirore. Ai e vështroi atë si një të ardhme të vjetër të ruajtur në gjuhën kishtarë tradicionale shqipe. Sipas tij, trajta *kam* + *paskajore* është më e re dhe më e zakonshme në librin e Buzukut, prandaj trajta e lidhores me vlerën e së ardhmes gjendet më shpesh në ato pjesë të librit që duket se vijnë nga një traditë më e hershme shkrimi të shqipes. Selman Riza¹⁶ e ka shpjeguar këtë veçori foljore të Buzukut si “shfaqje krijimtarie gjuhësore strukturore të autorit”. Shaban Demiraj¹⁷, duke kundërshtuar mendimin e

¹⁵. Martin Camaj, *Il Messale di Gjon Buzuku, Contributi linguistici allo studio della genesi* “Shejzat”, Roma 1960, f. 42-43.

¹⁶. Selman Riza, *Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe, krestomaci thjeshtë gjuhësore*, Tiranë 1961, f. XXIX.

¹⁷. Shaban Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë 1986, f. 817-819

S. Rizës, paraqet dy mundësi shpjegimi për këtë dukuri: ose ndikim latin i një tipi zgjedhimi foljor, në të cilin format e lidhore përkrijnë me ato të së ardhmes, ose trashëgim i një periudhe më të hershme, kur lidhja përdorej edhe me vlerën e së ardhmes. Autori anon, besojmë me të drejtë, nga shpjegimi i dytë.

Mendimi i Selman Rizës, i cili sheh te lidhja me vlerën e së ardhmes një krijim strukturor të vetëdijshëm të Gjon Buzukut, është e vështirë të pranohet po të kemi parasysh se kemi të bëjmë jo me një shfaqje të veçantë, por me një përdorim të shpeshtë e të integruar në mënyrë sistematike në paradigmen e zgjedhimit foljor në veprën e këtij autori. Ajo përdoret në mënyrë të zhdërvjelltë si sinonim gramatikor i së ardhmes së tipit *kam* +paskajoren *gege me punue*.

Nga ana tjetër, mundësia e një ndikimi latin që supozon Shaban Demiraj, besoj se duhet përjashtuar, sepse, siç tregojnë shembujt e cituar më sipër, Buzuku ka përdorur trajta të lidhore edhe në ato raste kur në tekstin latin kemi trajta të së ardhmes së tipit *cantabo*, *dabo*, *bibo* etj., që dallohen qartë nga trajtat e lidhore latine. Përveç kësaj, të tashmen e lidhore me vlerën e kohës së ardhme autori ynë e ka përdorur edhe në pasthënie të librit të tij e cila është pjesë origjinale dhe jo përkthim nga latinishtja. P. sh: *E atë në mbarofshi*, *Zotynë të ketë mishërierë*(= *do të ketë mëshirë*- S. M.) *mbi ju* (Meshari, Pasthënia, f. 387).

Në këto rrethana do të dukej më bindës mendimi se përdorimi i lidhore me vlerën kohore e modale të së ardhmes së dëftore nuk është as risi e Buzukut, as ndikim latin, por ruajtje në një të folme të veçantë e periferike të një dukurie gjuhësore që i përket një gjendjeje gjuhësore më të hershme të shqipes¹⁸. Ka të ngjarë që gjuha shqipe në një periudhë më të hershme parashkruar më së shpejti kuptimin kohor të së ardhmes, prandaj ka përdorur trajta të mënyrës lidhore dhe dëftore për të shprehur këtë kuptim gramatikor. Më e përshtatshme për të realizuar një kuptim të tillë ka qenë sigurisht mënyra lidhore. Kjo tezë e shprehur së pari, me sa dimë ne nga Martin Camaj, gjen mbështetje jo vetëm në librin e parë të gjuhës shqipe, por edhe në të dhënat e gramatikës së krahasuar për gjuhë të tjera indoeuropiane.

Përfaqësuesit më të njohur të gjuhësisë historike krahasuese si K. Brugman, A. Meillet, G. Bonfante etj. kanë mbrojtur tezën se

¹⁸ Shih për këtë edhe autorin e këtyre rradhëve, *Historia e kohës së ardhme në gjuhën shqipe sipas të dhënave të "Mesharit" të Gjon Buzukut*, në "Studime filologjike" nr. 3-4, 2005, f. 27-34.

indoeuropianishtja nuk kishte ndonjë formë të veçantë për kohën e ardhme. Po kështu edhe protosllavishtja dhe protogjermanishtja nuk kishin future; gjuhët gjermanike e kanë krijuar në epokën historike dhe në mënyra të ndryshme njëra nga tjetra. Vulfila ka përdorur rregullisht të tashmen për të përkthyer futurin grek në Katekizmin e tij. Futuri sigmatik i indoiranishtes, i greqishtes, i italikishtes, i keltishtes e i sllavishtes, sipas Brugman-it¹⁹, ka të ngjarë të ketë qenë një deziderativ i vjetër. A. Meillet ka shkruar: “Edhe gjuhët që kanë një zgjedhim të komplikuar mund të mos kenë forma gramatikore të veçanta për shprehjen e veprimeve të ardhme. I tillë është rasti gjuhëve semitike dhe i pjesës më të madhe të gjuhëve indoeuropiane. Gjermanishtja e vjetër nuk kishte trajtë të së ardhmes dhe është e vështirë të thuhet se ka edhe gjermanishtja e sotme. Për të shënuar një veprim të ardhshëm u drejtohem shpesh disa formave që tregojnë qëllimin për të bërë diçka. Forma gramatikore që kishte këtë kuptim në indoeuropianishten e përbashkët nga kanë dalë të gjitha gjuhët indoeuropiane, ishte mënyra lidhore. Kështu p. sh., në latinishte disa trajta si *erit* ose *dicet*, të cilat nga origjina janë trajta të lidhore, kanë marrë vlerën e së ardhmes, madje nuk kanë vlerë tjetër në latinishten e epokës historike. Vetëm gramatika historike e krahasuar mund të zbulojë që *erit* dhe *dicet* në latinishte kanë qenë në një periudhë prehistorike forma të lidhore”²⁰.

Në kontekstin e tezës së M. Camajt, sipas së cilës Buzuku disa pjesë të “Mesharit” mund të mos i ketë përkthyer vetë, por i ka gjetur të gatshme nga një traditë më e hershme e shkrimit të shqipes, mund të gjejë shpjegim edhe fakti që e ardhmja me foljen modale *dua* + *lidhore* përdoret vetëm një herë të vetme te ky tekst kaq i vëllimshëm, madje dhe ky rast është vënë në diskutim kohët e fundit.

¹⁹ K. Brugman, *Grundris* II f. 338 v.

²⁰ A. Meillet, *Linguistique historique dhe linguistique générale*, Paris 1921, p. 144-145.

